



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 15 maj 2023
Nr. Ref.:RK 2175/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI191/22

Parashtrues

Vegim Namligji

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [Rev. nr. 183/22] të 12 gushtit
2022 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Vegim Namligji, me vendbanim në Fushë-Kosovë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar me autorizim nga Salih Gjonbalaj dhe Argjent Sefa, avokatë në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev. nr. 183/22] të 12 gushtit 2022 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), lidhur me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa Individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 5 dhjetor 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 9 dhjetor 2022, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje e kërkesës ju dorëzua Gjykatës Supreme.
7. Më 20 dhjetor 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [nr. GJR. KI191/22] caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha.
8. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
9. Më 12 prill 2023, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin paraprak të propozuar nga gjyqtari raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

10. Nga shkresat e rastit rezulton se parashtruesi i kërkesës ka qenë në marrëdhënie pune në Korporatën Energjetike të Kosovës Sh. a. (në tekstin e mëtejme: punëdhënësi), në pozitën Zyrtar i Prokurimit.
11. Më tej, rezulton se punëdhënësi, përmes Raportit Konfidencial të Auditimit të Brendshëm [nr. 003-AP-2014] (në tekstin e mëtejme: Raporti i Auditimit) të ushtruar ndaj Departamentit të Prokurimit të Punëdhënësit, nga 23 janari 2014 deri më 12 shkurt 2014, ka dhënë rekomandim që ndaj parashtruesit të kërkesës dhe dy punëtorëve M. S. dhe Y. H., të iniciohet procedurë disiplinore dhe të shqiptohet masë disiplinore në

përputhje me Kodin Disiplinor, për shkelje të detyrave të punës dhe dështim në zbatim të ligjit të prokurimit lidhur me prokurimin e paraqitur në të gjeturat e raportit, e që rezultojnë me shkelje disiplinore sipas të njëjtit Kod dhe shkelje të ligjit të aplikueshëm, respektivisht Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Prokurimin Publik).

12. Më 3 mars 2014, parashtruesi i kërkesës pranë punëdhënësit kundërshtoi Raportin e Auditimit. Nga shkresat e lëndës nuk rezulton se punëdhënësi të jetë përgjigjur në ankesën e parashtruesit.
13. Më 6 mars 2014, punëdhënësi inicioi procedurën disiplinore ndaj parashtruesit të kërkesës, për shkelje të rëndë të detyrave të punës dhe që ndërlidhen me të gjeturat e Raportit të Auditimit.
14. Më 28 prill 2014, përmes Vendimit [nr. 921] punëdhënësi shqiptoi masën disiplinore “*Shkëputje e kontratës së punës*” ndaj parashtruesit të kërkesës, për shkak të shkeljes së dispozitave të Ligjit të Prokurimit Publik, veprime që paraqesin shkelje të rëndë të detyrave të punës të përcaktuara me paragrafin 1 të nenit 7 (Lidhje e kontratave të dëmshme) të Kodit disiplinor të punëdhënësit.
15. Më 6 maj 2014, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë tek punëdhënësi në shkallë të dytë, kundër vendimit të lartpërmendur me të cilin i ishte shkëputur marrëdhënia e punës.
16. Më 20 maj 2014, përmes Vendimit [nr. 1140] punëdhënësi refuzoi si të pabazë ankesën e parashtruesit të kërkesës.
17. Më 6 qershor 2014, parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) përmes të cilës kërkoi që i) të anulohen si të kundërligjshme Vendimi [nr. 921] të 28 prillit 2014 dhe Vendimi [nr. 1140] të 20 majit 2014 të punëdhënësit, dhe ii) të detyrohet punëdhënësi që parashtruesin e kërkesës ta kthejë në vendin e mëparshëm të punës me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, që nga 28 prilli 2014 e deri me datën e kthimit përfundimtar në punë.
18. Më 18 nëntor 2016, punëdhënësi parashtrroi përgjigje në padi, përmes të cilës kundërshtoi në tërësi padinë e parashtruesit të kërkesës, duke propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.
19. Më 16 shkurt 2018, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [C. nr. 1629/14], refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, si të pabazuar, duke konstatuar se bazuar në Raportin e Auditimit të Punëdhënësit parashtruesi i kërkesës ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës, duke lidhur kontratata të dëmshme për punëdhënësin si dhe kishte dështuar në zbatim të Ligjit për Prokurimin Publik.
20. Në arsyetim të Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore theksohet se në rastin e parashtruesit të kërkesës shkelja e rëndë e detyrave të punës, së pari është konstatuar nga Raporti i Auditimit dhe më pas është vërtetuar nga Komisioni Disiplinor, i cili me vendim i shkëputi marrëdhënien e punës parashtruesit të kërkesës. Më tej, në Aktgjykimin e lartpërmendur shtohet se “*Për rastin sipas çështjes Ministria e Punës, Inspektorati i Punës kanë përpiluar raport zyrtar me rastin e inspektimit në KEK sipas autorizimeve të Ligjit të Punës me dt. 30.06.2014, të cilat kanë dhënë mendimin e vet me shkrim me dt. 10.07.2014. Pas kërkesës së paditësit dhe zyrtarëve të tjerë të KEK-ut për këtë çështje, Inspektorati i Punës nga Ministria e Punës në bazë të Ligjit të Punës me dt. 04.07.2014 kanë prurë vendim me të cilin konsiderohen të pabazuara kërkesat e*

zyrtarëve të Zyrës së prokurimit të KEK-t si dhe për Vegim Namligjiu, lidhur me vendimin e KEK-ut nr. 923 i dt. 28.04.2014/ me ankesat e palëve e edhe të paditësit Vegim Namligjiu inspektorati i punës i Ministrisë së Punës si shkallë e dytë ka pru vendim nr. 74/14 i dt. 02- 0409-14 me të cilin refuzohet e pabazuar ankesa e palëve zyrtarëve të Zyrës së prokurimit të KEK-ut e edhe e paditësit. Nga gjendja e vërtetuar faktike, Gjykata ka gjetur se e paditura ka vepruar konform dispozitave të brendshme të të paditurës kur paditësit ia ka shqiptuar masën largim nga puna, pasi që shkeljet e gjetura si të aprovuara paraqesin bazë për masën të cilën e ka shqiptuar e paditura”.

21. Më 14 mars 2018, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të ligjit material.
22. Më 18 janar 2022, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 1911/18], vendosi si në vijim: i) pranoi si të bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës; ii) ndryshoi Aktgjykimin [C. nr. 1629/14] të 16 shkurtit 2018 të Gjykatës Themelore; iii) miratoi në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe anuloi vendimet [nr. 921] dhe [nr. 1150] të 20 majit 2014 dhe iv) detyroi punëdhënësin që në afat prej 7 ditësh ta kthejë parashtruesin e kërkesës në punë, si dhe në emër të fitimit të humbur për mosrealizimin e të ardhurve personale për periudhën nga 28 prilli 2014 deri më 31 mars 2017, t’ia paguajë parashtruesit të kërkesës shumën prej 21,463.77 euro, me kamatën në lartësi prej 8% vjetore.
23. Gjykata e Apelit më tej në arsyetim të Aktgjykimit të saj theksoi se përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës Themelore është i gabuar, pasi që Aktgjykimi është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Po ashtu, në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit theksohet se Aktgjykimi i shkallës së parë nuk është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe gjendja faktike është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, por e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar.
24. Më 14 mars 2022, punëdhënësi parashtrroi revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Thelbi i pretendimit të punëdhënësit në revizion është: “vendimi mbi shkëputjen e marrëdhënies së punës paditësit është tërësisht i ligjshëm dhe i njëjti ka ardhur si pasojë e veprimeve të vet paditësit, e që këto veprime janë paraparë si shkelje të rënda të detyrave të punës të parapara në kodin disiplinor nr. 2, përkatësisht nenin 7, par.1 pika (m) dhe (r) të kodit disiplinor nr. 2 të KEK. Sh.a. Paditësi me veprimet e veta ka bërë shkelje të rënda të dispozitave të Ligjit të Prokurimit, Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik UOPP sepse nuk ka kryer procedurën e blerjes për vlera minimale konform nenit 48. par.3, nuk ka respektuar çmimin e tregut të përcaktuar me nenin 48. 45, nuk janë kontaktuar operatorët ekonomik konform nenit 48 par.5”.
25. Më 12 shtator 2022, përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 183/22], Gjykata Supreme pranoi si të bazuar revizionin e punëdhënësit duke ndryshuar Aktgjykimin [Ac. nr. 1911/18] e Gjykatës së Apelit dhe duke lënë në fuqi Aktgjykimin [C. nr. 1629/14] e Gjykatës Themelore. Në arsyetim të Aktgjykimit të kontestuar, Gjykata Supreme theksoi se qëndrimin juridik të shkallës së dytë “nuk e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit, pasi që aktgjykimi i shkallës së dytë është përfshirë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit të kontestuar, atij i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 23 [Dinjteti i Njeriut], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] si dhe nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës.
27. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit për shkelje të nenit 23 [Dinjteti i Njeriut] parashtruesi i kërkesës thekson se deri tek shkelja e nenit të lartcekur të Kushtetutës ka ardhur sepse gjykatat e rregullta, kanë vendosur ndryshe në rastin e dy kolegëve të parashtruesit të kërkesës dhe të cilët kanë qenë pjesë e të njëjtës procedurë gjyqësore. Në ndërlidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës shton se i është cenuar dinjteti *“për faktin se dy kolegët e tij që ishin në të njëjtin proces gjyqësor [Y. H dhe M. S] nga gjykatat e rregullta kishin marrë vendime në favorin e tyre për dallim nga z. Vegim Namligjiu”*.
28. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] ky i fundit shton se nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë, lidhur me aplikimin e dispozitave ligjore, sepse: *“në bazë të njëjtave dispozitave ligjore dhe procedurave ligjore është bërë largimi nga puna i parashtruesit të kërkesës”* duke theksuar se kolegët e tij janë kthyer në punë dhe në këtë mënyrë *“barazia para ligjit dhe trajtimi apo interpretimi i ligjit në raport me z. Vegim Namligjiu nuk ka qenë i drejtë. Nga aplikimi i ligjit të punës, Kodit Disiplinor të Korporatës Energjetike të Kosovës dhe Kontrata e Punës”*.
29. Parashtruesi i kërkesës pretendon gjithashtu shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] duke pretenduar se rasti i tij nuk është trajtuar në mënyrë të njëjtë në raport me dy kolegët e tij, edhe përkundër rrethanave të njëjta faktike dhe juridike. Parashtruesi i kërkesës më tej kishte theksuar se gjykatat e rregullta kishin nxjerrë vendime të ndryshme në raste të njëjta.
30. Në kuadër të pretendimit të parashtruesit për shkelje të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk është i arsyetuar, duke shtuar se i njëjti është marrë me përshkrim të dispozitave ligjore, por nuk ka adresuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës. Parashtruesi në ndërlidhje me këtë thekson se *“Aktgjykimi i Gjykatës Supreme më tepër i ngjason në një Aktgjykim të Gjykatës së Apelit si gjykatë e faktit se sa me atë të një gjykate që është garant për mbrojtje të ligjshmërisë së vendimeve gjyqësore”*.
31. Më tutje, parashtruesi i kërkesës shton se Gjykata Supreme nuk ka pasur qëndrim për zbatimin e ligjeve në mënyrë të drejtë dhe të barabartë në realizimin e të drejtave të të njëjtit nga marrëdhënia e punës, duke iu referuar sërish vendimeve të Gjykatës Supreme ndaj ish-kolegëve të tij.
32. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të konstatojë se Aktgjykimi [Rev. nr. 183/22] i 12 shtatorit 2022 i Gjykatës Supreme nuk është në përputhshmëri me nenet e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të njëjtin ta shpallë të pavlefshëm dhe ta kthejë në Gjykatën Supreme për rivendosje dhe trajtim të barabartë.

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 23 **[Dinjiteti i Njeriut]**

Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Neni 24 **[Barazia para Ligjit]**

- 1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
- 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*
- 3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.*

Neni 31 **[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

- 1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*
- 3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medie, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.*
- 4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.*
- 5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.*
- 6. Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.*
- 7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit.*

Neni 54 **[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]**

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Neni 102 **[Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]**

1. Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga gjykatat.
2. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata.
3. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.
4. Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm.
5. Garantohet e drejta për ankesë ndaj një vendimi gjyqësor, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe. E drejta e përdorimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, rregullohet me ligj. Me ligj mund të lejohet e drejta për të referuar një rast në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, dhe për të tilla raste nuk ka të drejtë ankese.

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6 **(E Drejta për një proces të rregullt)**

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohe shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...]"

LIGJI Nr. 03/L-212 I PUNËS

Neni 10 **Kontrata e Punës**

1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuari. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji.
2. Kontrata e Punës mund të lidhet për:
 - 2.1. një periudhë të pacaktuar;
 - 2.2. një periudhë të caktuar; dhe
 - 2.3. për punë dhe detyra specifike.
3. Kontrata e punës që nuk përmban kurrfarë hollësish për kohëzgjatjen e vet, duhet të konsiderohet si kontratë në periudhë të pacaktuar.
4. Kontrata për periudhë të caktuar nuk mund të lidhet për një periudhë më të gjatë se dhjetë (10) vite.

5. Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.

6. Kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë se njëqindënjëzet (120) ditë brenda një (1) viti.

7. Personi që ka lidhur kontratë të punës për një afat të caktuar ose për një detyrë specifike, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parapara me këtë ligj, përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj.

8. Të punësuarit për një punë specifike, nuk i takon e drejta në pushim vjetor dhe të drejtat e tjera të përcaktuara me Kontratë Kolektive dhe Kontratën e Punës.

9. Me Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit, përcaktohet koha në rastet kur me të punësuarin mund të themelohet marrëdhënia e punës në kohë të caktuar dhe punë specifike, në pajtim me këtë ligj.

Neni 11

Përmbajtja e Kontratës së Punës

1. Kontrata e Punës përmban;

1.1. të dhënat për punëdhënësin (emërtimi, selia dhe numrin e regjistrimit të biznesit); 1.2. të dhënat për të punësuarin (emri, mbiemri, kualifikimi dhe vendbanimi);

1.3. emërtimin, natyrën, llojin e punës, llojin shërbimeve dhe përshkrimin e detyrave të punës;

1.4. vendin e punës dhe njoftimin që puna do të kryhet në lokacione të ndryshme,

1.5. orët dhe orarin e punës;

1.6. datën e fillimit të punës;

1.7. kohëzgjatjen e Kontratës së Punës;

1.8. lartësinë e pagës bazë, si dhe ndonjë shtesë ose të ardhur tjetër,

1.9. kohëzgjatjen e pushimeve;

1.10. përfundimin e marrëdhënies së Punës;

1.11. të dhëna të tjera për të cilat punëdhënësi dhe punëmarrësi i vlerësojnë të rëndësishme për rregullimin e marrëdhënies së punës;

1.12. kontrata e Punës mund të përmbajë të drejta dhe detyra të tjera të parashikuara me këtë ligj;

1.13. të drejtat dhe detyrimet të cilat nuk janë të përcaktuara me Kontratën e Punës, rregullohen me dispozitat e këtij ligji, Kontratën Kolektive dhe Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit;

2. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për nevojat e punëdhënësve do të përgatisë mostra të kontratave të punës sipas standardeve minimale, për periudhë të pacaktuar, të caktuar dhe për punë specifike.

Neni 72

Procedura para Ndërprerjes së Kontratës

1. Vendimi për të ndërprerë kontratën e punës duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të përfshijë arsyetimin për ndërprerje.

2. Vendimi nga paragrafi 1. i këtij neni është përfundimtar ditën kur i dorëzohet të punësuarit.

3. Punëdhënësi është i obliguar të bëjë pagesën e pagës dhe të ardhurave të tjera, deri në ditën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

4. Punëdhënësi mund t'i ndalojë qasjen punonjësit në objektin e ndërmarrjes gjatë periudhës së njoftimit, përkatësisht para ndërprerjes së kontratës së punës.

Neni 79

Mbrojtja e të Punësuarit në Gjykatë

Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78, paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.

Neni 80

Vendosja gjyqësore lidhur me ndërprerjen e kontratës së punës

1. Nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore, në bazë të dispozitave të këtij ligji, Kontratës Kolektive ose Kontratës së Punës, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të ekzekutoj njërën prej këtyre dëmshpërblimeve:

1.1. t'i paguajë të punësuarve kompensimin, përveç shtesave dhe shumave tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të këtij ligji, Kontratës së Punës, Kontratës Kolektive ose Aktit të Brendshëm, në shuma të tilla që gjykata i konsideron të drejta dhe adekuate, por të cilat nuk duhet të jenë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit; ose

1.2. nëse largimi nga puna vlerësohet si i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, Gjykata mund ta rikthej të punësuarin në vendin e tij të punës dhe urdhëron kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna.

2. Punëdhënësi është i obliguar që në afatin e caktuar të zbatoj vendimin e gjykatës kompetente.

LIGJI NR. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Neni 7

Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do t'i trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik.

3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndaloheq që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasisë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

5. Autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose (ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos furnizojë ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik. Në rast se një kërkesë e tillë është veçanërisht e autorizuar nga ky ligj, ndonjë ligj tjetër ose marrëveshje ndërkombëtare, parametrat e saktë të një

kërkese të tillë do të saktësohen në kontratë ose në njoftimin e konkursit të projektimit, ftesën për pjesëmarrje ose tenderim, dhe në dosjen e tenderit.

6. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kriterëve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse.

Neni 48 Dorëzimi i Dosjes së Tenderit

1. Nëse operatori ekonomik me kohë ka parashtruar një kërkesë për të marrë një dosje të tenderit që i përmbush kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës përkatëse nga autoriteti përkatës kontraktues shprehimisht kërkohet që t'ia dorëzojë operatorit përkatës ekonomik dosjen e kërkuar të tenderit pa pagesë, siç vijon:

1.1. nëse afati i caktuar kohor për pranimin e tenderëve është më shumë se tridhjetë (30) ditë, jo më vonë se gjashtë ditë pas pranimit të kërkesës së tillë;

1.2. nëse afati i caktuar kohor për pranimin e tenderëve është më shumë se njëzet (20) ditë por më pak se tridhjetë (30) ditë, jo më vonë se katër ditë pas pranimit të kërkesës së tillë; dhe

1.3. nëse afati kohor për pranimin e tenderëve është më i shkurtër se njëzet (20) ditë, jo më vonë se tri (3) ditë pas pranimit të kërkesës së tillë.

2. Pavarësisht kërkesës së dorëzimit të dosjes së tenderit pa pagesë sipas paragrafit 1 të këtij neni autoriteti kontraktues mund të vendosë një tarifë në rastet, kur shpenzimet për prodhim të materialit të tenderit janë të larta si në rastet, kur ato përmbajnë modele apo numër të madh të kopjeve teknike. Shuma e tarifës së kërkuar në këto raste nuk bënë të tejkaloj shumën e prodhimit të këtij materiali kërkesës.

Pranueshmëria e kërkesës

33. Gjykata së pari vlerëson nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

34. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

35. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

36. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë, siç janë cekur më lart, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në cilësinë e palës së autorizuar, duke e kontestuar një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev. nr. 183/22] të 12 gushtit 2022 të Gjykatës Supreme të Kosovës.
37. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
38. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton si në vijim:

Rregulli 39
(Kriteret e pranueshmërisë)

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”

[...]”

39. Gjykata rikujton se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajtja e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih, rastin e Gjykatës: KI04/21, parashtruese [Nexhmije Makolli](#), Aktvendim për papranueshmëri, i 12 majit 2021, paragrafi 26; shih, gjithashtu, rastin KI175/20, parashtruese [Agjencia Kosovare e Privatizimit](#), Aktvendim për papranueshmëri, i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
40. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta”. Këtë koncept të papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi e pabazuar”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara” të zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata i ka përvetësuar edhe në praktikën e saj gjyqësore përfshirë, por duke mos u kufizuar në rastet KI40/20 me parashtrues [Sadik Gashi](#), Aktvendim për papranueshmëri, i 20 janarit 2021; KI163/18, me parashtrues [Kujtim Lleshi](#), Aktvendim për papranueshmëri, i 24 qershorit 2020; dhe KI21/21, me parashtrues, [Asllan Meka](#), Aktvendim për papranueshmëri, i 28 prillit 2021.
41. Në këtë kontekst, dhe në vazhdim, për të vlerësuar pranueshmërinë e kërkesës, përkatësisht, për të vlerësuar nëse në rrethanat e këtij rasti kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilat, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
42. Gjykata rikujton se esenca e rastit ndërlidhet me ndërprerjen e marrëdhënies së punës së parashtruesit të kërkesës nga ana e punëdhënësit, bazuar në Raportin e Auditimit. Parashtruesi i kërkesës më pas kishte kontestuar vendimin e punëdhënësit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, por kërkesa e tij ishte refuzuar si e pabazuar. Parashtruesi i kërkesës parashtrroi padë në Gjykatën Themelore kundër vendimit të punëdhënësit për largimin nga puna, duke kërkuar i) anulimin e këtij të fundit; ii) kthim në vendin e punës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që dalin nga marrëdhënia e punës. Gjykata Themelore refuzoi si të pabazuar padinë e parashtruesit duke konsideruar se ky i fundit kishte bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës, shkelje kjo e cila së pari është konstatuar nga Raporti i Auditimit dhe më pas është vërtetuar nga Komisioni Disiplinor, i cili me vendim i shkëputi marrëdhënien e punës parashtruesit të kërkesës, duke respektuar të gjitha procedurat ligjore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Pas ankesës që parashtruesi i kërkesës e ushtroi në Gjykatën e Apelit, kjo e fundit e ka pranuar ankesën si të bazuar duke ndryshuar Aktgjykimin të Gjykatës Themelore dhe rrjedhimisht miratoi në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Më pas punëdhënësi parashtrroi revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Gjykata Supreme miratoi revizionin

duke anuluar Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe duke lënë në fuqi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, me të cilin padia e parashtruesit ishte refuzuar si e pabazuar.

43. Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme përmes vendimit të kontestuar kishte shkelur të drejtat e parashtruesit të garantuara me nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit] nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës, kryesisht për faktin se gjykatat e rregullta kishin nxjerrë vendime të ndryshme për raste të njëjta (parashtruesi kryesisht në kërkesën e tij thirret në dy raste të ish-kolegëve të tij të cilët kishin qenë të përfshirë të njëjtën procedurë gjyqësore).
44. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në substancë pretendon se i) përmes vendimeve të gjykatave të rregullta është trajtuar në mënyrë të pabarabartë në raport me dy kolegët e tij që kanë qenë të përfshirë në të njëjtën procedurë gjyqësore; ii) cenim të parimit të sigurisë juridike si rezultat i vendimeve kundërthënëse të Gjykatës Supreme si dhe ii) mosarsyetim të vendimit gjyqësor.
45. Në vazhdim të adresimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata të njëjtat do t'i trajtoj ndaras duke filluar me pretendimin e parashtruesit përkitazi i) mungesën e konsistencës të vendimeve gjyqësore, duke shtjelluar parimet e përgjithshme të vendosura përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës, në pajtim me atë të GJEDNJ-së në kontekst të garancive procedurale të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për të vazhduar me pretendimin për mungesën e arsyetimit të vendimit gjyqësor; ii) pretendimin për shkelje të së drejtës për barazi para ligjit të garantuar me nenin 24 [Barazia para Ligjit]; duke vazhduar më tej me pretendimin e parashtruesit për shkeljen e nenit 23 [Dinjiteti i Njeriut], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës.
- (i) Parimet dhe kriteret e vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës përkitazi me mungesën e konsistencës të vendimeve gjyqësore*
46. Gjykata fillimisht thekson se parimet dhe kriteret e vendosura nga GJEDNJ, kjo Gjykatë gjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesve për cenimin e parimit të sigurisë juridike, si rezultat i vendimeve kundërthënëse i ka zbatuar edhe në praktikën e saj gjyqësore (shih rastet e Gjykatës KI87/18, parashtrues *"IF Skadeforsikring"*, Aktgjykim i 27 shkurtit 2019 dhe KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, Aktgjykim i 6 janarit, ku Gjykata, ndër të tjera, konstatoi shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të cenimit të parimit të sigurisë juridike, si rezultat i divergjencës në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së).
47. Në dritën e zhvillimit të parimeve të përgjithshme përkitazi me mungesën e konsistencës të vendosura përmes praktikës gjyqësore, Gjykata fillimisht i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila ka theksuar vazhdimisht se një nga komponentët thelbësorë të sundimit të ligjit është siguria juridike, e cila, ndër të tjera, garanton një siguri të caktuar në situata juridike dhe kontribuon në besim publik në gjykata (shih, rastin e GJEDNJ-së *Brumărescu kundër Rumanisë* [DHM], kërkesa nr. 28342/95, paragrafi 61; rastin *Ştefănică dhe të tjerët kundër Rumanisë*, kërkesa nr. 38155/02, Aktgjykim i 2 nëntorit 2010, paragrafi 38, dhe rastin *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, kërkesa nr. 13279/05, Aktgjykim i 20 tetorit 2011, paragrafi 56).

48. Sipas GJEDNJ-së “prezenca e vendimeve kundërthënëse gjyqësore, në anën tjetër, mund të krijojë situata të pasigurisë juridike, e cila do ta ulte besimin e publikut në sistemin gjyqësor”. (shih, rastin *Padurararu kundër Rumanisë*, kërkesa [nr. 63252/00](#), paragrafi 98; *Vinčić dhe të tjerët kundër Serbisë*, kërkesat [nr. 44698/06](#), paragrafi 56, Aktgjykim i 1 dhjetorit 2009; dhe rasti *Ştefăniţă dhe të tjerët kundër Rumanisë*, të cituar më lart, paragrafi 38). GJEDNJ, megjithatë, ka specifikuar se nuk ka një të drejtë të fituar për konsistencë të praktikës gjyqësore. (shih, rastin *Unédic kundër Francës*, kërkesa [nr. 20153/04](#), paragrafi 74, 18 dhjetor 2008, shih rastin e cituar më lartë *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, paragrafi 56, shih po ashtu rastin e cituar më lart të Gjykatës KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, paragrafi 65, si dhe rastin KI42/17, parashtrues [Kushtrim Ibraj](#), Aktvendim për papranueshmëri, i 25 janarit 2018, paragrafi 33).
49. Në vijim, GJEDNJ ka vendosur tri kritere themelore, të cilat janë pranuar edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës për të përcaktuar nëse një divergjencë e vendimeve gjyqësore e pretenduar përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, dhe të cilat përcaktojnë si në vijim: (i) nëse ekzistojnë dallime “të thella dhe afatgjata” në praktikën gjyqësore; (ii) nëse ligji vendor përcakton mekanizma të aftë për të zgjidhur divergjenca të tilla; dhe (iii) nëse ata mekanizma janë zbatuar dhe me çfarë efekti (në këtë kontekst, shih rastet e GJEDNJ-së, *Beian kundër Rumanisë* (nr.1), kërkesa [nr. 30658/05](#), Aktgjykim i 6 dhjetorit 2007, paragrafët 37 -39; *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, kërkesa [nr. 76943/11](#), Aktgjykimi i 29 nëntorit 2016, paragrafët 116 - 135; *Jordan Jordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, kërkesa [nr. 23530/02](#), Aktgjykim i 2 korrikut 2009, paragrafët 49-50; *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 53; dhe shih rastin e Gjykatës, KI29/17, parashtrues [Adem Zhegrova](#), Aktvendim për papranueshmëri, i 5 shtatorit 2017, paragrafi 51 dhe shih gjithashtu rastet e Gjykatës të cituar më lart, KI42/17, parashtrues [Kushtrim Ibraj](#), paragrafi 39, KI87/17 parashtrues “*IF Skadiforsikring*”, paragrafi 67, të cituar më lart, KI35/18 parashtrues “*Bayerische Versicherungsverband*”, të cituar më lart, paragrafi 70, KI107/19, parashtrues [Gafurr Bytyqi](#), Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2020).
50. Gjykata vëren se GJEDNJ gjatë zhvillimit të konceptit të “dallimeve të thella dhe afatgjata” gjithashtu mori parasysh nëse mospërputhja është e izoluar apo afekton një numër të madh njerëzish (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 135).
51. Gjykata në këtë drejtim gjithashtu thekson se GJEDNJ nuk ka konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së në raste të praktikës divergjente gjyqësore edhe nëse e njëjta ka afektuar një numër të madh njerëzish në lidhje me të njëjtën çështje gjatë një periudhe të shkurtër kohore para se kundërthëniet përkatëse të zgjidheshin nga gjykatat më të larta, duke u dhënë mundësi kështu mekanizmave shtetërorë që të sigurojnë konsistencën e duhur (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Albu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 10 majit 2012, paragrafët 42 - 43).
52. Kjo e fundit ndërlihet me kriterin e dytë dhe të tretë, përkatësisht me ekzistencën e një mekanizmi të aftë për të zgjidhur mospërputhjet në praktikën gjyqësore dhe nëse ky mekanizëm është përdorur dhe me çfarë efekti. Në këtë drejtim, GJEDNJ fillimisht ka konstatuar se mungesa e një mekanizmi të tillë përbën shkelje të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor të garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së. (Shih, në këtë kontekst, *Tudor Tudor kundër Rumanisë*, kërkesa [nr. 21911/03](#), Aktgjykim i 4 marsit 2009, paragrafët 30-32; dhe *Ştefăniţă dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 2 shkurtit 2010, paragrafët 37-38; dhe *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 54).

(ii) Zbatimi i këtyre parimeve dhe kritereve në rrethanat e rastit konkret

53. Në vijim, Gjykata do të aplikojë parimet e elaboruara më lart në rrethanat e rastit konkret, duke aplikuar kriteret mbi bazën e të cilave Gjykata dhe GJEDNJ trajton çështjet e divergjencës përkitazi me praktikën gjyqësore, duke filluar me vlerësimin nëse në rrethanat e rastit konkret, (i) divergjencat e pretenduara në praktikën gjyqësore janë “të thella dhe afatgjata”; dhe nëse ky është rasti, (ii) ekzistimin e mekanizmave të aftë për të zgjidhur divergjencën përkatëse; dhe (iii) vlerësimin nëse këta mekanizma janë zbatuar dhe me çfarë efekti në rrethanat e rastit konkret.
54. Fillimisht, Gjykata duhet gjithashtu të ritheksojë se, bazuar edhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe asaj të Gjykatës, nuk është funksioni i saj të krahasojë vendime të ndryshme të gjykatave të rregullta, edhe nëse merren në procedura dukshëm të ngjashme, pasi që pavarësia e tyre duhet të respektohet (shih rastin e GJEDNJ-së *Adamsons kundër Letonisë*, cituar më lart, paragrafi 118, shih po ashtu rastet e Gjykatës KI87/18 parashtrues *IF Skadeforsikring* dhe KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, të cituara më lart).
55. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës lidhur me pretendimet për shkelje kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore si rezultat i divergjencave në praktikën gjyqësore, duhet t’ia paraqesin Gjykatës argumentet përkatëse përkitazi me ngjashmërinë faktike dhe juridike të rasteve të cilat pretendojnë se janë zgjidhur ndryshe nga gjykatat e rregullta, duke rezultuar në vendime kundërthënëse në praktikën gjyqësore dhe e cila mund të ketë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së (shih rastin e cituar më lart KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, paragrafi 76).
56. Në këtë drejtim, Gjykata së pari rikujton pretendimin e parashtruesit të kërkesës i cili thekson se rasti i tij nuk është trajtuar në mënyrë të njëjtë në raport me dy kolegët e tij, edhe përkundër rrethanave të njëjta faktike dhe juridike, duke shtuar se gjykatat e rregullta kishin nxjerrë vendime të ndryshme në raste të njëjta.
57. Bazuar në atë si më sipër, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në mbështetje të pretendimit të tij për cenim të parimit të sigurisë juridike, si rezultat i divergjencës në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme, ka dorëzuar në Gjykatë dy raste të ndryshme, respektivisht i) Aktgjykimin [Rev. nr. 185/2019] të 12 qershorit 2019 të Gjykatës Supreme si dhe vendimet e instancave më të ulëta që i kanë paraprirë aktgjykimit të lartpërmendur; si dhe ii) Aktgjykimin [C. nr. 469/19] të 3 janarit 2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë e cila kishte vendosur në rigjykim duke përfshirë edhe vendimet që i kanë paraprirë këtij të fundit. Vendimet të cilat parashtruesi i kërkesës i ka dorëzuar në Gjykatë, pretendon se rasti i tij ngërthen rrethana të njëjta faktike dhe juridike me ato të rastit të vendosur përmes vendimit të kontestuar.
58. Gjykata vëren se në të dyja rastet që parashtruesi i kërkesës i ka sjellë në Gjykatë, duke pretenduar se ngërthejnë të njëjtat rrethana si rasti i tij, në të dyja rastet palë ndërgjyqëse janë ish-kolegët e tij, gjithashtu punëtorë tek i njëjti punëdhënës. Megjithatë, në rastin e parë, Gjykata Supreme duke vendosur sipas kërkesës për revizion nga ana e punëdhënësit, përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 185/2019] të 12 qershorit 2019, refuzoi revizionin si të pabazuar duke mbështetur qëndrimin juridik të dy instancave më të ulëta, me arsyetimin se pala paditëse nuk kishte bërë shkelje të detyrave të punës dhe se në veprimet e këtij të fundit nuk ka veprime kundërligjore që mund të kualifikohen si shkelje të detyrave të punës të përcaktuara në nenin 7, paragrafi 1 pika (m) dhe (r) të Kodit Disiplinor të paditurit. Rasti tjetër të cilin parashtruesi i kërkesës e kishte dorëzuar në Gjykatë duke pretenduar se është i njëjtë me rastin e tij,

respektivisht Aktgjykimin [C. nr. 469/19] e Gjykatës Themelore, e cila në rivendosje, aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, duke theksuar ndër të tjera se punëdhënësi nuk kishte respektuar procedurën ligjore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Në të dyja rastet e lartpërmendura, gjykatat e rregullta kishin konstatuar se përgjatë procedurës disiplinore të zhvilluar tek punëdhënësi nuk kishte qenë i pranishëm përfaqësuesi i Sindikatës.

59. Gjykata, duke iu rikthyer pretendimit të parashtruesit të kërkesës se Gjykata Supreme dhe ato të instancave më të ulëta, në dy raste identike ka vendosur ndryshe, Gjykata rikujton se në rastet KI87/18 dhe KI35/18 cituar më lart, ka konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të shkeljes së parimit të sigurisë juridike si rezultat i divergjencës së praktikës gjyqësore, në rastin KI87/18 në vlerësimin e 3 (tre) rasteve të Gjykatës Supreme, të nxjerra në një periudhë kohore 3 (tre) vjeçare, dhe në rastin KI35/18 në vlerësimin e 9 (nëntë) rasteve të Gjykatës Supreme të nxjerra në një periudhë kohore 5 (pesë) vjeçare dhe pasi kishte konstatuar se (i) kishte *“dallime të thella dhe afatgjata”*; (ii) mekanizmi i Gjykatës Supreme për harmonizimin e praktikës gjyqësore ekzistonte; porse (iii) mekanizmi i lartpërmendur nuk ishte përdorur (shih, rastet e Gjykatës KI87/18, cituar më lart, paragrafi 79 dhe paragrafët 81 deri 85, dhe rastin KI35/18, cituar më lart, paragrafi 70 dhe paragrafët 110-111).
60. Përderisa, Gjykata në rastet e saj KI29/17, KI42/17, KI35/18 dhe KI107/19 të cituara më lart kishte vlerësuar, se nuk mund të konstatohen *“dallime të thella dhe afatgjata”*, në krahasimin e vetëm 2 (dy) rasteve edhe nëse të njëjtat mund të jenë kundërthënëse. Në këtë rast, në një rrethanë të tillë, ku parashtruesit i referohen vetëm një vendimi, i cili përmban konstatim dhe përfundim ndryshe nga vendimi, i nxjerrë në rastin e parashtruesve, Gjykata nuk kishte konstatuar se ishte cenuar parimi i sigurisë juridike (shih rastet e Gjykatës: K29/17, i cituar më lart, paragrafi 53, KI42/17, i cituar më lart, paragrafi 44, KI35/18, i cituar më lart, paragrafët 104 dhe 114, dhe KI107/19, i cituar më lart, paragrafi 75).
61. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në Gjykatë ka dorëzuar Aktgjykimin [Rev. nr. 185/2019] të 12 qershorit 2019 të Gjykatës Supreme, për të cilin rast përmes dorëzimit të të gjitha parashtresave në lidhje me këtë rast ka pretenduar lidhshmërinë faktike dhe juridike me atë të rastit të tij. Megjithatë, duke iu referuar këtij rasti të referuar nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata edhe një herë rikujton se Gjykata Supreme përmes Aktvendimit të saj [Rev. nr. 185/2019] të 12 qershorit 2019, kishte konstatuar si të pabazuar revizionin e punëdhënësit, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, duke theksuar se: *“paditësi nuk ka bërë shkelje të detyrave të punës dhe se në veprimet e të paditurit nuk ka veprime kundërligjore që mund të kualifikohen si shkelje të detyrave të punës të përcaktuara në nenin 7, paragrafi 1 pika (m) dhe (r) të Kodit Disiplinor të paditurit”*. Rasti tjetër të cilin parashtruesi i kërkesës e kishte dorëzuar në Gjykatë duke pretenduar se është i njëjtë me rastin e tij, respektivisht Aktgjykimin [C. nr. 469/19] e Gjykatës Themelore, e cila në rivendosje, aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar ndër të tjera se punëdhënësi nuk kishte *“respektuar procedurën ligjore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës”*.
62. Ndërsa në rastin e parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të saj [Rev. nr. 183/22], pranoi si të bazuar revizionin e punëdhënësit, duke ndryshuar Aktgjykimin [Ac. nr. 1911/18] e Gjykatës së Apelit dhe duke lënë në fuqi Aktgjykimin [C. nr. 1629/14] e Gjykatës Themelore. Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj theksoi se nga interpretimi i dispozitave ligjore të Ligjit të Punës, nenit 11 të Kontratës së Punës të 1 qershorit 2013, Kodit Disiplinor të KEK-ut, të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik si dhe nga shqyrtimi i të gjitha provave dhe shkresave të lëndës Gjykata Supreme e Kosovës, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e

paditësit është në tërësi e pabazuar, duke shtuar “Në këtë kuptim gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka konstatuar dhe ka vendosur që kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pabazuar si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se paditësi dhe e paditura raportin e tyre – të drejtat dhe detyrat e tyre, punëdhënës – punëmarrës i kanë rregulluar me kontratë në formë të shkruar, duke përcaktuar saktë të drejtat dhe detyrat e tyre reciproke, gjykata ka konstatuar se kontrata e punës është lidhur në pajtim të plotë me dispozitat ligjore të cekura më lart, se kushtet e kontratës së punës të lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës duke marrë për bazë kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës, si dhe shkëputja e marrëdhënies së punës, siç ka ndodhur në këtë rast është në pajtim të plotë me dispozitat ligjore të Ligjit të Punës – nenit 11 të Kontratës së Punës të datës 01.06.2013, Kodit Disiplinor të KEK-ut, të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik”.

63. Bazuar në atë si më sipër, Gjykata vëren se Gjykata Supreme në rastin e parashtruesit të kërkesës kishte konstatuar se qëndrimin juridik të shkallës së dytë nuk e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit, pasi që i njëjti është i përfshirë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
64. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është i arsyetuar dhe se interpretimi i Gjykatës Supreme, sa i përket fakteve të paraqitura për vlerësim nga parashtruesi i kërkesës, nuk mund të thuhet se ishte arbitrarisht, i paarsyeshëm apo të ketë mundur të ndikojë në gjykim të drejtë, por ishte thjesht çështje e interpretimit dhe zbatimit të ligjit (shih në mënyrë analoge, rastin KI29/17, parashtrues Adem Zhegrova, të cituar më lart, paragrafi 57).
65. Duke rikujtuar detyrimin e përcaktuar përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës që parashtruesit e kërkesës duhet t'i paraqesin Gjykatës argumentet përkatëse përkitazi me ngjashmërinë faktike dhe juridike të rasteve të cilat pretendojnë se janë zgjidhur ndryshe nga gjykatat e rregullta, duke rezultuar në vendime kundërthënëse në praktikën gjyqësore, Gjykata vëren se përveç dorëzimit të një rasti të vetëm në procedurë dhe një Aktgjykimi tjetër të Gjykatës Themelore, ku parashtruesi pretendon rrethanat faktike dhe juridike të ngjashme si ato në rastin e parashtruesit, parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur që Gjykatës t'i paraqesë argumente shtesë, apo raste tjera që janë vendosur ndryshe nga Gjykata Supreme, dhe rrjedhimisht ta mbështesë pretendimin e tij për cenim të sigurisë juridike, si rezultat i vendimeve kundërthënëse të Gjykatës Supreme.
66. Andaj, në dritën e praktikës së vet gjyqësore, Gjykata vlerëson se nuk është e mundur të konstatohet ekzistimi i “dallimeve të thella dhe të vazhdueshme” në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme që rrezikojnë parimin e sigurisë juridike, duke u thirrur në një Aktgjykim të Gjykatës Supreme, të nxjerrë 3 (vite) më herët dhe një Aktgjykim të Gjykatës Themelore të nxjerrë dy (2) vite më herët (shih në mënyrë analoge rastin KI29/17, parashtrues Adem Zhegrova, të cituar më lart, paragrafi 53).
67. Prandaj, Gjykata konsideron se as numri i aktgjykimeve të pretenduara si kundërthënëse, as periudha kohore brenda së cilës janë nxjerrë këto aktgjykime, si dhe as mënyra se si Gjykata Supreme ka vlerësuar dhe trajtuar rastin e parashtruesit të kërkesës nuk krijojnë bazë të mjaftueshme për të arsyetuar pretendimin për shkelje të parimit të sigurisë, si rrjedhojë e vendimeve kundërthënëse të Gjykatës Supreme (shih rastin KI29/17, të cituar më lart, paragrafi 58).

Përkitazi me pretendimin e parashtruesit për barazi para ligjit të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës

68. Në ndërlidhje me pretendimin e parashtruesit për shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] Gjykata rikujton se në thelb parashtruesi pretendon se nuk është trajtuar në

mënyrë të barabartë, lidhur me aplikimin të dispozitave ligjore, sepse: “në bazë të njëjtave dispozitave ligjore dhe procedurave ligjore është bërë largimi nga puna i parashtruesit të kërkesës” duke theksuar se kolegët e tij janë kthyer në punë dhe në këtë mënyrë “barazia para ligjit dhe trajtimi apo interpretimi i ligjit në raport me z. Vegim Namliqiu nuk ka qenë i drejtë. Nga aplikimi i ligjit të punës, Kodit Disiplinor të Korporatës Energjetike të Kosovës dhe Kontrata e punës.

69. Gjykata para së gjithash dëshiron të rikujtojë se, si rregull i përgjithshëm, barazia para ligjit nënkupton trajtimin e barabartë të individëve që ndodhen në kushte dhe rrethana të njëjta apo të ngjashme, duke përfshirë edhe të drejtën e tyre për mbrojtje të barabartë me ligj. Megjithatë, barazia para ligjit nuk do të thotë që për një individ ose një kategori personash, që janë në kushte objektivisht të ndryshme, duhet të kenë trajtim dhe zgjidhje të njëjlojta.
70. Për më tepër, praktika e GJEDNJ-së sqaron se, sipas kuptimit të nenit 14 të KEDNJ-së, një trajtim diskriminues konsiderohet vetëm atëherë kur “ai nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm”, që do të thotë se, ai nuk ndjek një “qëllim legjitim”, apo kur trajtimi nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti “midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që arrihet” (shih, për shembull gjykimin e 28 majit 1985 në çështjen *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesat [nr. 9214/80, 9473/81, 9474/81](#), Seria A, nr. 94, para 78).
71. Gjykata rikujton se përgjatë arsytimit të pretendimit të parashtruesit përkitazi me divergjencën e praktikës gjyqësore, në ndërlidhje me të dyja rastet që parashtruesi i kërkesës i ka sjellë në Gjykatë, dhe në të cilat parashtruesi është thirrur, duke pretenduar se është trajtuar ndryshe nga ish-kolegët e tij, gjithashtu punëtorë tek i njëjti punëdhënës, Gjykata, pas analizimit të vendimeve gjyqësore të dy rasteve të lartpërmendura, konstatoi se në të njëjtat rrethana faktike dhe juridike dallojnë dukshëm nga rasti i parashtruesit të kërkesës.
72. Siç është elaboruar më lart, tek rasti i parashtruesit të kërkesës Gjykata Supreme kishte pranuar revizionin e punëdhënësit duke konstatuar se Gjykata e Apelit kishte zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe kishte lënë në fuqi aktgjykimin e shkallës së parë, me arsytimin se shkoputja e marrëdhënies së punës në rastin e parashtruesit të kërkesës ishte bërë në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit të Punës.
73. Përderisa në rastet që parashtruesi i kishte sjellë në Gjykatë, dhe për të cilat pretendon se rasti i tij është trajtuar ndryshe, Gjykata rikujton se në të dyja rastet përveç të tjerave punëdhënësi nuk kishte respektuar procedurën ligjore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Në rastet e lartpërmendura, gjykatat e rregullta gjithashtu kishin konstatuar se përgjatë procedurës disiplinore të zhvilluar tek punëdhënësi nuk kishte qenë prezent përfaqësuesi i Sindikatës.
74. Në këtë këndvështrim, Gjykata konsideron se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk përmban elemente të shkeljes së barazisë para ligjit, përkatësisht elemente të trajtimit të pabarabartë, siç pretendon parashtruesi i kërkesës. Për më tepër, asnjë nga bazat e kërkuara sipas Kushtetutës, kur këto interpretohen në dritën e Konventës, nuk e mbështesin pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtave themelore, sepse, ai në asnjë mënyrë nuk dëshmon dhe argumenton se gjykatat e rregullta e trajtuan atë në mënyrë të pabarabartë dhe diskriminuese (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI173/18, parashtrues [Nijazi Pasoma](#), Aktvendim për papranueshmëri, i 22 korrikut 2019, paragrafi 32).
75. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për barazi para ligjit, të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës për shkak të

trajtimin të pabarabartë të parashtruesit në lidhje me palët e treta janë (i) pretendime të cilat cilësohen si pretendime të “*shkallës së katërt*”; dhe si të tilla këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përkitazi me pretendimin e parashtruesit për shkelje të nenit 23, 49, 54 dhe 102 të Kushtetutës

76. Sa i përket shkeljes së të drejtave të garantuara me nenet 23, 49, 54 dhe 102 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se sipas praktikës së themeluar gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim me kriterin (iii) e pretendimeve “të pambështetura apo të paarsyetuara” kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, përkatësisht:
- a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (shih, në këtë drejtim, rastin e GJEDNJ-së *Trofimchuk kundër Ukrainës (vendim)* nr. [4241/03](#) i 31 majit 2005, shih gjithashtu *Baillard kundër Francës (vendim)* nr. [6032/04](#) i 25 shtatorit 2008);
 - b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin KI166/20, parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, 5 janarit 2021, paragrafi 42).
77. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës thjesht pretendon shkelje të neneve 23, 49, 54 dhe 102 të Kushtetutës, por ai nuk arsyeton, përkatësisht nuk shpjegon se si ka ardhur deri te shkelja e këtyre neneve.
78. Sa i përket këtyre pretendimeve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës vetëm i përmend nenet përkatëse, por nuk shtjellon më tutje se si dhe përse ka ardhur deri të shkelja e këtyre neneve përkatëse të Kushtetutës. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi i neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së dhe përmendja e tyre nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet KI175/20, cituar më lart, paragrafi 81, KI166/20 cituar më lart, paragrafi 52, KI04/21 cituar më lart, paragrafët 38- 39).
79. Prandaj, Gjykata konstaton se përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet 23, 49, 54 dhe 102 të Kushtetutës, Gjykata konstaton se kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që i takojnë kategorisë (iii) së pretendimeve “të pambështetura ose të paarsyetuara” sepse parashtruesi i kërkesës thjesht citoi një ose më shumë dispozita të Konventës ose të Kushtetutës, pa shpjeguar se si ato janë shkelur. Prandaj, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
80. Si përfundim, në pajtim rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 12 prill 2023, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani